

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-017/12

**Prishtinë,
19 shkurt 2012**

Në çështjen juridike të:

D.T

Paraqitësi i kërkesës /Pala ankuese

kundër

M.M

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva- Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/120/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin nr. KPA01081), të datës 07 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me datën 19 shkurt 2012, morri këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohet ankesa e D.T si e pabazuar.
- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/120/2011 i datës 07 shtator 2012 për sa i takon lëndës së regjistruar me nr. KPA01081.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 80 (tetëdhjetë euro) brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me datën 16 gusht 2007, D.T ka paraqitur një kërkesë në emër të nënës së tij S.K në cilësinë e titullares së paluajtshmërisë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte të njëjtoj si pronar i paluajtshmërisë që gjendet në Gjilan, Rruga “Marashall Tito” 53, ngastra nr. 3802, në sipërfaqe prej 101 m². Ndërkohë ai saktëson se pala përgjegjëse ia ka uzurpuar vetëm një pjesë të kësaj ngastre në sipërfaqe prej 32 m². Ai kërkonte ri-posedim e kësaj prone si dhe kompensimin për shtëpinë e shkatërruar. Ai ka sqaruar se nëna e tij S.K ka qenë pronare kësaj ngastre ku është ndërtuar shtëpia, se ai i kishte humbur ato më 1 janar 1999 dhe se humbja ka qenë si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë.

Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës i ka paraqitur AKP-së këto dokumente edhe atë:

- Çertifikatën e lindjes të lëshuar nga Komuna e Vranjës Republika e Serbisë me datë 17dhjetor 2003, në emër të D.T ku konstatohet se nëna e tij ka qenë S.K;
- Letërnjoftimin e UNMIK-ut, të lëshuar me 09 tetor 2001 në emër të S.K;
- Letërnjoftimin e lëshuar nga Komuna e Gjilanit me datë 22 tetor 1997, në emër të D.T;
- Çertifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL -70403013-01406 e datës 19 mars 2010 të lëshuar nga Zyra Kadastrale Gjilan, me të cilën konstatohet se ngastra kadastrale 3802 e Zonës Kadastrale Gjilan në Rr.”M.Tito” në sipërfaqe prej 269 m² është e regjistruar në emër të S.K,

Këto dëshmi - dokumente janë verifikuar pozitivisht.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur edhe një sërë dokumentesh tjera, por atë nuk ndërlidhen me kërkesën e tij.

Për shkak se njoftimi i parë i datës 4 gusht 2008 është bërë gabimisht, atëherë është bërë ri-njoftimi me 30 prill 2010 dhe se si palë përgjegjëse është paraqitur M.M duke pretenduar të drejtë e pronës që është objekt i kësaj kërkesë. Në emër të babait të tij njoftimin e palës përgjegjëse e ka nënshkruar djali i tij SH.M, dhe se këtë të fundit e përfaqëson I.M, avokat nga Gjilani.

Për t'i mbështetur pretendimet e tije ai ka paraqitur këto prova edhe atë:

- Padinë e deponuar në Gjykatën Komonale në Gjilan C.nr.532/05 me datë 19 tetor 2005 me të cilën kërkon pjesën kontestuese pre 32m² të ngastrës kontestuese,
- Aktvendimin e Gjykatës Komonale në Gjilan C.nr 532/05 i datës 7 prill 2010, me të cilin caktohet masa e përkohshme e ndalimit të tjetërsimit dhe regjistrimit të kësaj ngastrave kadastrale në regjistrat përkatës të autoriteteve kompetente derisa të përfundojë kontesti gjyqësor.

Këto dokumente janë verifikuar pozitivisht.

Pala përgjegjëse ka paraqitur edhe prova tjera por ato nuk janë relevantë në këtë çështje juridike.

Me vendimin e KPCC/D/C/120/2011 i datës 07 shtator 2011 është hedhur poshtë kërkesa e D.T në cilësinë e paraqitësit të kërkesës me arsyetim që sipas nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për të vendosur në këtë çështje juridike, ngase procedura gjyqësore lidhur me pronën e kërkuar ka filluar në vitin 2005. Sipas kësaj dispozite ligjore parashikohet juridiksioni i KPCC përjashtohet nëse ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me kërkesën para 16 tetorit 2006, kur edhe kjo Rregullore ka hyrë në fuqi.

Vendimi i KPKK-ës i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 5 dhjetor 2011. Ai ka ushtruar ankesë kundër këtij vendimi me 19 dhjetor 2011, brenda afatit ligjor të parashikuar sipas dispozitave të nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Vendimi i KKPK-ës i është dorëzuar palës përgjegjëse me 7 dhjetor 2011. Ankesa e ushtruar nga ana e ankuesit/paraqitësit të kërkesës i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë/palës përgjegjëse në kërkesë me 27 Janar 2012. Ai është përgjigjur në ankesë me datë 3 shkurt 2012.

Parashtruesi i kërkesës-ankesës në ankesën e tij i përsërit pretendimet e paraqitura në kërkesën e tij, duke theksuar se ai posedon dokumente të mjaftueshme se nëna e tij është pronare e pronave të kërkuara, duke shtuar gjithashtu se mbi bazën e trashëgimisë ai edhe është pronar i pronës së kërkuar. Më tutje ai ka kërkuar edhe kompensimin e dëmit për shtëpinë e shkatërruar në shumë prej € 300.000. Ai thekson se Gjykata Komunale në Gjilan me aktvendimin C.nr.523/05 i datës 07 shtator 2011 ka konstatuar se është tërhequr padia e paditësit SH.M e paraqitur kundër të paditurës S.K.

Me 27 janar 2012, në përgjigjen në ankesë, pala përgjegjëse në kërkesë/ankesë ka theksuar se kontesti sipas padisë së paditësit C.nr. 532/05 është duke u proceduar në gjykatën Komunale në Gjilan, duke qenë se me aktvendimin me të njëjtin numër veprues i datës 07 nëntor 2012 me propozim të paditësit është kthyer në gjendjen e mëparshme.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është dorëzuar brenda periudhës 30 ditore siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se vendimi i kundërshtuar i KPKK-ës është marr me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi këtë bazë drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale si dhe ajo procedurale ,ndaj edhe ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Sipas nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parashikohet se juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me kërkesën para 16 tetorit 2006, kur ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Duke qenë se procedura gjyqësore në lidhje me pronën e kërkuar ka filluar me paraqitjen e padisë së palës përgjegjëse në Gjykatën Komunale në Gjilan me C.nr.523/05 me datë 04 nëntor 2005, atëherë sipas vlerësimit të kësaj gjykate i drejtë dhe i ligjshëm është vendimi ankimor i KPKK-ës, kur ka konkluduar se për shkak të mungesës së juridiksionit të këtij Komisioni kërkesa është hedhur poshtë. Prandaj, procedimi i mëtejshëm lidhur me pronën e kërkuar të paraqitësit të kërkesës bie në juridiksionin e Gjykatës Komunale në Gjilan.

Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të Gjykatës Supreme ishin pretendimet e parashtruesit të kërkesës-ankesës i cili kryesisht i përsërit pretendimet e paraqitura në kërkesën e tij, duke theksuar se ai posedon dokumente të mjaftueshme se nëna e tij është pronare e pronave të kërkuara, duke shtuar gjithashtu se mbi bazën e trashëgimisë ai edhe është pronar i pronës së kërkuar. Më tutje ai ka kërkuar edhe kompensimin e dëmit për shtëpinë e shkatërruar në shumë prej € 300.000. Objekt shqyrtimi i kësaj Gjykate ishte edhe aktvendimi C.nr.523/05 i datës 7 shtator 2011, i Gjykates Komunale në Gjilan, me të cilin është konstatuar se është padia

e paraqitur nga paditësi SH.M kundër të paditurës S.K, është tërhequr. Gjykata përfundimisht ka gjetur se pretendimet e tilla të parashtruesit të janë të pabazuara, të papranueshme, kundërthënëse dhe të kundërligjshme. Kjo pikërisht për arsye se padia e paraqitësit të kërkesës, që e ka për objekt (të njejten parcel) dhe subjekt (familjen e njejtë) është identike me kërkesën e cila është paraqitur në Gjykatën Komonale të Gjilanit me numër C.nr.523/05 me datë 4 nëntor 2005. Për më tepër, gjykata me aktvendimin e saj C.nr.523/05 datë 20 Janar 2012, ka abroguar aktvendimin e datës 7 nëntor 2012, me të cilin është konstatuar se kërkesa e paraqitur e paraqitësit të kërkesës (Sh. M.) e paraqitur nga pala përgjegjëse S. K. është tërhequr. Prandaj, bazuar në këtë, procedura e mëtutjeshme duhet të udhëhiqet mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga paraqitësi i kërkesës/palës përgjegjëse në ankesë.

Ndërkaq, sipas nenit 18 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, parashikohet se juridiksioni i Komisionit përjashtohet nëse ka filluar procedura gjyqësore në lidhje me kërkesën para 16 tetorit 2006, kur ka hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50. Prandaj, në këtë rast konkret për shkak të mungesës së juridiksionit kërkesa është hedhur poshtë si vendim procedural dhe rrjedhimisht nuk është vendosur për meritat e vendimit që i referohen objektit të kërkesës. Gjithashtu, i drejtë dhe i ligjshëm është vendimi i KPKK-ës edhe kur ka vendosur që të hedhet kërkesa për kompensimin e dëmit, ngase sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me te.

Rrjedhimisht mbi të mësipërmen, Gjykata Supreme konkludon se vendimi i KPKK-ës është i drejtë i ligjshëm dhe i njëjti ka dhënë shpjegime dhe sqarime të mjaftueshme për faktet vendimtare për një vendim të tillë. Vendimi ankimor nuk është përfshi me shkelje thelbësore të ligjit material dhe procedural sipas nenit 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079. Prandaj, refuzohet ankesa e ankuesit si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi ankimor i KPKK-ës si i drejtë dhe i ligjshëm sipas nenit 13.3 (c) Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me Shtojcën III, Neni 8.4 i Urdhresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet për procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme ankimore:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të llogaritet të jetë € deri në 10000€= 50.00€

Këto tarifa gjyqësore merren përsipër nga pala ankuese i cili humb rastin. Në përputhje me nenin 45, paragrafi 1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është 15 ditë. Neni 47 paragrafi 3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nuffer, Referent i EULEX-it